

QËNDRIMI NDAJ BASHKIMIT KOMBËTAR / INTEGRIMI EVROPIAN

Sa i përket dëshirës së realizimit të bashkimit kombëtar, 63% e të anketuarve në Shqipëri dhe 54% e të anketuarve në Kosovë deklarohen se dëshirojnë që bashkimi kombëtar të realizohet. Por të pyetur nëse do të ishin të gatshëm të paguanin një taksë e cila mundëson bashkimin kombëtar, 29.5% e të anketuarve në Shqipëri do të ishin dakord me një taksë të tillë dhe 43.5% e të anketuarve në Kosovë.

75% e të anketuarve në Shqipëri dhe 64% e të anketuarve në Kosovë do të votonin pro bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë në një shtet të vetëm, nëse do të mbahej një referendum. Besimi bie në të dyja vendet kur pyeten se sa mendojnë se bashkimi kombëtar është i mundshëm, ku vetëm 23% e shqiptarëve të Shqipërisë dhe 17% e shqiptarëve të Kosovës besojnë se një gjë e tillë është e mundur.

Për shqiptarët e Shqipërisë të cilët besojnë se bashkimi kombëtar është i mundshëm, bashkësia ndërkombëtare shihet si faktor kryesor që mundëson bashkimin. Kurse për shqiptarët e Kosovës faktor kryesor që mund të realizoj një skenar të tillë shihet liderhipi në Kosovë dhe Shqipëri. Por edhe ata që mendojnë se bashkimi kombëtar nuk mund të ndodhë, faktorin ndërkombëtar e shohin si pengesë kryesore, si të anketuarit në Shqipëri, ashtu edhe ata në Kosovë. Bashkimi kombëtar dhe anëtarësimi i Shqipërisë dhe Kosovës në BE shihen si procese që kundërshtojnë njëra tjetrën nga 42% e të anketuarve në Kosovë dhe 37% e të anketuarve në Shqipëri. Shqiptarët e Shqipërisë, në shkallë më të madhe se sa shqiptarët e Kosovës, kanë tendencë të shohin këto dy procese si komplementare.


PERCEPTIMI I ROLIT TË SHQIPËRISË NË KOSOVË/ BASHKËPUNIMI

Sa i përket qëndrimit zyrtar të Shqipërisë karshi Kosovës, qytetarët e të dyja vendeve pajtohen se Shqipëria luan rolin e "vëllait të madh" ndaj Kosovës. Për serbët e Kosovës, Shqipëria ndërhyr shumë në punët e brendshme të Kosovës, por me këtë nuk pajtohen shqiptarët e të dyja vendeve. Shumica e të anketuarve në Shqipëri dhe Kosovë (qytetarët shqiptarë) vlerësojnë se marrëdhëniet mes dy vendeve nuk janë zhvilluar mjaftueshëm dhe se ka ende punë për t'u bërë. Pjesa më e madhe e të anketuarve (76% në Shqipëri dhe 59% në Kosovë) vlerësojnë se zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kosovës sjell përfitime për të dy vendet njëjloj.



76% **59%**

vlerësojnë se zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kosovës sjell përfitime për të dy vendet njëjloj.



70%
KUNDËR

Skenarët për mundësinë e korigjimit të kufijve janë kundërshtuar nga shqiptarët në Kosovë



52%
KUNDËR

QËNDRIMI NDAJ DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Skenarët për mundësinë e korigjimit të kufijve janë kundërshtuar nga shqiptarët në Kosovë (mbi 70% kundër) dhe Shqipëri (mbi 52% kundër), por gjithashtu dhe nga serbët e Kosovës (mbi 80% kundër). Njëkohësisht shumica e të anketuarve në Kosovë dhe Shqipëri nuk e preferojnë as 'status quo' e tanishme në marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë dhe presin ndryshim, por i cili nuk do të prekte territorin.

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

KOSOVË – SHQIPËRI

Ndërveprimi, njohuritë, vlerat, besimet, bashkëpunimi dhe bashkimi



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) në fund të vitit 2018 kanë përfunduar një hulumtim të gjerë në Kosovë dhe Shqipëri për të matur ndërveprimin dhe qëndrimet e qytetarëve të të dyja vendeve sa i përket një sërë çështjesh, si: ndërveprimi, distanca sociale, imazhet për fqinjët, qëndrimet ndaj bashkëpunimit zyrtar të të dyja vendeve dhe qëndrimet ndaj bashkimit kombëtar. Gjatë tetorit dhe nëntorit 2018 janë anketuar 2,504 qytetarë në të dyja vendet: 1,200 në Shqipëri dhe 1,304 në Kosovë (1,004 shqiptarë dhe 300 serbë). Mbledhja e të dhënave është realizuar sipas të njëjtës metodologji por nga dy kompani të ndryshme, përkatësisht IDRA në Shqipëri, ndërsa Kantar TNS Index Kosova në Kosovë. Format i anketës dhe numri i pyetjeve ka qenë i njëjtë në të dyja vendet, kurse për qytetarët serbë në Kosovë është përdorur një version më i shkurtër i anketës.



NDËRVEPRIMI

Sipas hulumtimit në të dy vendet, 88.7% e shqiptarëve të Kosovës kanë vizituar Shqipërinë, ndërkohë që vetëm 31.6% e qytetarëve të Shqipërisë kanë vizituar Kosovën. Vetëm 18% e të anketuarve nga komuniteti serb që jetojnë në Kosovë kanë vizituar Shqipërinë në dy vitet e fundit. Turizmi është arsyeja kryesore për vizitat e ndërsjellta, ndërkohë shumë pak vend zë arsimi, shëndetësia, tregtia dhe punësimi. Kufizimet financiare dhe largësia janë dy arsyet kryesore për mos realizimin e vizitave në vendin tjetër. Lidhur me sigurinë e udhëtimit në vendin tjetër, 85% e të anketuarve në Shqipëri deklarojnë se ndihen të sigurtë ose shumë të sigurtë për të udhëtuar në Kosovë, 60% e qytetarëve të Kosovës kanë këtë siguri. Vetëm 18% e qytetarëve serb në Kosovë ndihen të sigurtë për të udhëtuar në Shqipëri.




DISTANCA SOCIALE/ETNIKE

Pjesa më e madhe e të anketuarve shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë kanë deklaruar se nuk do kishin asnjë problem që të kenë marrëdhënie shoqërore me dikë nga Kosova/Shqipëria, të jetojnë në një fshat, qytet, lagje me dikë nga Kosova/Shqipëria, apo të punojnë në të njëjtin vend pune. Lidhur me pyetjen nëse do të preferonin që të kenë lidhje martesore me shqiptarët nga Shqipëria/Kosova, 75% e të anketuarve në Shqipëri janë shprehur se nuk e kanë problem një gjë të tillë, ndërkohë 56% e të anketuarve në Kosovë japin përgjigje pozitive. Shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërisë kanë distancë më të madhe me serbët, se sa me malazezët dhe grekët. Marrëdhëniet shoqërore me serbët nuk i preferojnë 84% e shqiptarëve të Kosovës dhe 67% e shqiptarëve të Shqipërisë. Sa i përket distancës sociale me dikë nga Evropa Perëndimore, mesatarisht 85% e shqiptarëve të Shqipërisë dhe 65% e shqiptarëve të Kosovës shprehen në favor të lidhjeve shoqërore, të jetuarit në një vendbanim ose ndarjes së vendit të punës.

LIDHUR ME PYETJEN NËSE DO TË PREFERONIN QË TË KENË LIDHJE MARTESORE ME SHQIPTARËT NGA SHQIPËRIA/KOSOVA,

75%
e të anketuarve në Shqipëri janë shprehur se nuk e kanë problem një gjë të tillë, ndërkohë

56%
e të anketuarve në Kosovë japin përgjigje pozitive.



NJOHURITË

Shqiptarët e Kosovës janë më të informuar sa i përket figurave politike të institucioneve kryesore të Shqipërisë dhe datave historike të saj, krahasuar me qytetarët e Shqipërisë për Kosovën. Qytetarët e të dyja vendeve kanë tendencë të mbivlerësojnë përqindjen e minoriteteve që jetojnë në Kosovë, respektivisht Shqipëri. Qytetarët e Kosovës ndjekin më shumë mediat e Shqipërisë, se sa anasjelltas: **34% e të anketuarve në Shqipëri** kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë ndjekur mediat e Kosovës (TV/gazeta/portale), kurse **17% e shqiptarëve të anketuar në Kosovë** deklarojnë se nuk ndjekin kurrë mediat e Shqipërisë; 45% e shqiptarëve të Kosovës kanë deklaruar se ndjekin çdo javë ose disa herë në javë mediat e Shqipërisë, kurse të njëjtën e deklarojnë 23% e qytetarëve të Shqipërisë për mediat e Kosovës.

MIQTË DHE ARMIQTË E PËRBASHKËT/IMAZHET

Shqiptarët në të dyja anët e kufirit kanë qëndrime të njëjta sa i përket shteteve mike dhe agresore ndaj Shqipërisë dhe Kosovës. Shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës pajtohen se shtete si Gjermania, Italia, Franca, SHBA, Kroacia dhe Turqia, janë shtete mike për të dyja vendet. Dy shtetet me qëndrim armiqësor, si për Kosovën dhe për Shqipërinë, konsiderohen Serbia dhe Rusia.

BASHKIMIT KOMBËTAR

